

VENDIM
Nr. 139, datë 8.10.2012

**PËR NDRYSHIMIN E STRUKTURËS SË KUOTAVE TË KAPITALIT THEMELTAR TË
SHOQËRISË “HEC-I DRAGOSTUNJE” SHPK**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 6.2 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike” dhe pikës 5.2 të licencës “Për tregtimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.10.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Hec-i Dragostunje” sh.p.k., për marrjen e autorizimit për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e kësaj shoqërie, dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

1. Shoqëria “Hec-i Dragostunje” sh.p.k. është licencuar nga ERE përkatësisht:
 - në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet: “Zanore”, “Dragostunje”; “Hotolisht” dhe “Ura” me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 25, datë 10.3.2011; dhe
 - në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 26, datë 10.3.2011.
2. Ristrukturimi i pjesëmarrjes së kapitalit që ka ndërmarrë shoqëria “Hec-i Dragostunje” sh.p.k. shkakton ndryshimin e aksionerit që kontrollon interesat.
3. Ndryshimi i aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë i shërben zhvillimit të projekteve koncesionare për fazat në vazhdim.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të autorizojë shoqërinë “Hec-i Dragostunje” sh.p.k., për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani